

UDHËZIM
Nr.2348, datë 17.4.2009

MBI DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 6257, DATË 2. 9.2008
“MBI PËRCAKTIMIN E MASËS SË SUBVENCIONIT PËR FAMILJET QË
PËRFITOJNË KREDI TË LEHTËSUARA NGA SHTETI”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 25 të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, i ndryshuar,

UDHËZOJMË:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

1/1. Masa e subvencionit të interesave të kredisë (subvencioni), për familjet, sipas pikës 7 të këtij udhëzimi, të jetë e barabartë me interesin vjetor të kredisë në tregun e lirë, sipas marrëveshjes së nënshkruar midis Ministrisë të Financave dhe bankës. Këto familje paguajnë vetëm principalin e kredisë me interes 0%.

2. Pas pikës 7 shtohen pikat si më poshtë:

7/1. Për efekt të përfitimit të subvencionit, familjet që përfshihen në pikën 7, dhe që nuk janë verifikuar në terren nga EKB, paraqiten pranë zyrave rajonale të EKB për rifreskimin e dokumentacionit si më poshtë:

a) Vërtetim negativ nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme që, në emër të kryefamiljarit dhe anëtarëve të tjerë të familjes nuk figuron pronë e regjistruar ose në proces regjistrimi;

b) Dokumentin e lëshuar nga këshilli bashkiak për dhënien e statusit;

c) Certifikatën e gjendjes familjare të datës 31 dhjetor 1992;

d) Adresën e banesës së/dhe emrin e pronarit të banesës.

7/2. Zyrat rajonale të Entit Kombëtar të Banesave shpallin listat në vende të dukshme dhe çdo individ që pretendon se nuk figuron në lista mund të paraqitet me dokumentacionin përkatës, sipas pikës 3 pranë zyrave rajonale të EKB për verifikim. EKB pasi shqyrton dhe verifikon dokumentacionin dhe i gjen ato në përputhje me pikën 3, i përfshin në lista dhe njofton bashkinë përkatëse.

7/3. Listat e familjeve që përfshihen në pikën 7, të cilat janë miratuar me vendime të këshillave bashkiake dhe i janë dërguar Entit Kombëtar të Banesave, i dërgohen nga ky i fundit bankës me të cilën është nënshkruar marrëveshja me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe një kopje bashkive respektive.

7/4. Listat përmbajnë emrin e kryefamiljarit dhe strukturën e familjes, sipas certifikatës familjare të muajit dhjetor 1992 dhe strukturën e apartamentit që përfiton.

7/5. Bazuar në numrin e kontratave të kreditimit që mund të lidhen nga banka, kjo e fundit njofton radhën e paraqitjes pranë zyrave për lidhjen e kontratave, sipas renditjes të listave të dërguara nga EKB.

2. Në fund të pikës 8 shtohet një fjali si më poshtë:

“Kjo procedurë nuk ndiqet për familjet sipas pikës 7 të këtij udhëzimi”.

3. Pas fjalisë së parë të pikës 11 të udhëzimit nr.6257, datë 2.9.2008, shtohen fjalitë më këtë përmbajtje:

“Kufiri maksimal i kreditimit në këtë tabelë llogaritet sa 80% e vlerës së apartamentit të blerë në treg. Për qytetet e tjera që nuk përfshihen në tabelë, vlera maksimale e kredisë përcaktohet nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit rast pas rasti sipas të dhënave zyrtare mbi çmimin e shitblerjes së apartamenteve në treg dhe i njoftohet bankës

me të cilën është lidhur marrëveshja e bashkëpunimit”.

4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode